

V E N D I M

Nr.27, datë 21.1.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.423, DATË 9.7.1998 “PËR
PJESËMARRJEN, ME KONTRATË ADMINISTRIMI, TË SEKTORIT PRIVAT, NË
NDËRMARRJET E UJËSJELLËSVE, TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TË
RRETHEVE TIRANË DHE Durrës” DHE PËR PËRFSHIRJEN E NDËRMARRJES
SË UJËSJELLËSIT TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TË RRETHIT TË TIRANËS
NË KONTRATËN PËR ASISTENCË TEKNIKE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.423, datë 9.7.1998, pika 1 ndryshon si vijon:
“Të miratojë formën e marrëveshjes me kontratë administrimi, për pjesëmarrjen e sektorit privat në ndërmarrjen e ujësjellësit të Durrësit.”.
2. Ndërmarrjet e ujësjellësit të bashkisë së Tiranës dhe të rrethit të Tiranës të përfshihen në kontratën për asistencë teknike.
3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**